



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 93

Tiranë – E hënë, 20 qershor 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 416, datë 15.6.2022	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim Krujë, Bashkia Krujë..... 11861
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 16, datë 15.6.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 31, datë 26.12.2013, “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistrimi”, të ndryshuar..... 11887
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 115, datë 6.6.2022	Për miratimin e rregullores për kërkesat, përmbajtjen e regjistrit dhe procedurat e regjistrimit, çregjistrimit ose ndryshimit të të dhënave në Regjistrin e Avionëve Civilë të Republikës së Shqipërisë..... 11889



VENDIM
Nr. 416, datë 15.6.2022

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
DHE SHKËMBIMIN E PRONËS, NË
FUNKSION TË PROCESIT TË
RINDËRTIMIT, NË ZONËN E RE PËR
ZHVILLIM KRUJË, BASHKIA KRUJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar; të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”; të vendimit nr. 7, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për kushtet dhe procedurat për shpronësimet dhe/ose shkëmbimin e pronës për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar; të vendimit nr. 8, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 132, datë 13.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim Krujë, Bashkia Krujë, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin dhe/ose shkëmbimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit, që realizohet në zonën e re për zhvillim Krujë, Bashkia Krujë, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi dhe shkëmbimi i pronës bëhen në favor të Bashkisë Krujë.

3. Shkëmbimi i pasurive të paluajtshme, pronë private, për të cilat pronarët kanë pranuar kompensimin, me shkëmbim, për pasuritë e llojit “ndërtesë banimi” dhe “ndërtesë jobanimi”, me një

pasuri të ardhshme në pronësi të shtetit, bëhet referuar legjislacionit në fuqi, sipas cilësimeve në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe marrëveshjeve/kontratave paraprake që janë lidhur dhe lidhen ndërmjet Bashkisë Krujë dhe qytetarëve që shprehin dakordësinë, brenda periudhës së zbatimit të projektit.

4. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, në vlerën 26 107 432 (njëzet e gjashtë milionë e njëqind e shtatë mijë e katërqind e tridhjetë e dy) lekë.

5. Vlera e përgjithshme e kompensimit prej 26 107 432 (njëzet e gjashtë milionë e njëqind e shtatë mijë e katërqind e tridhjetë e dy) lekësh, përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit dhe i transferohet Bashkisë Krujë, në buxhetin e vitit 2022, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

6. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë origjinale ose dublikatën, kartelën e pasurisë të rifreskuar, si dhe hartën treguese të regjistrimit, pranë Bashkisë Krujë, referuar aktmarrëveshjes së lidhur.

7. Shpronësimi fillon menjëherë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

8. Bashkia Krujë kryen likuidimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të shpronësuar dhe bën shkëmbimin e pronës, referuar aktmarrëveshjeve të lidhura.

9. Afati i kryerjes së shpronësimit në vlerë monetare do të jetë momenti i fillimit të realizimit të projektit. Afati i kryerjes së shkëmbimit të pronës private me një pronë shtetërore të ardhshme, sipas marrëveshjeve të nënshkruara, do të jetë në përfundim të realizimit të projektit për zhvillimin në zonën e re për zhvillim Krujë, Bashkia Krujë.

10. Bashkia Krujë i kërkon Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, që brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit të shpronësimit dhe të shkëmbimit, ose nga data që ka marrë formë të prerë vendimi i gjykatës, në rast se kompensimi kryhet nëpërmjet shkëmbimit të pronës private me një pasuri shtetërore të ardhshme, në kartelën e pasurisë për pronën truall, ku do të krijohet pasuria e ardhshme, regjistruar në Agjencinë Shtetërore të



Kadastrës, bëhet regjistrimi i barrës ligjore, sipas legjislacionit në fuqi, në favor të pronarit privat, për përfitimin në të ardhmen të pasurisë shtetërore, kur kjo e fundit të regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Kur pronari/pronarët privatë, që kanë pranuar kushtet e shkëmbimit, pjesë të kërkesës për regjistrim janë dhe marrëveshjet përkatëse. Me regjistrimin e pasurisë së ardhshme në regjistrin përkatës pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me kërkesë të njësisë zbatuese dhe të përfaqësuesit të pronarit shtet, bëhet regjistrimi i kalimit të të drejtave të pronësisë për pronën shtet, në favor të pronarit privat.

11. Bashkia Krujë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi, i kërkon Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të kryejë regjistrimin e pasurive, pronë private, të shpronësuara, sipas legjislacionit në fuqi dhe referuar aktmarrëveshjes së lidhur.

12. Gjatë periudhës së zbatimit të projektit (përfundimit të punimeve), qytetarët, nëse nuk kanë në pronësi ose në posedim objekte të tjera banimi, do të strehohen nga njësi e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet programeve të rindërtimit, të parashikuara në aktin normativ nr. 9, datë

16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, ose në legjislacionin në fuqi për strehimin social.

13. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Krujë për pasuritë e shpronësuara.

14. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

15. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Bashkia Krujë, si dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA PROCESI I RINDËRTIMIT NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM KRUJË, FAZA E PARË, BASHKIA KRUJË

[illegible]

Page | 11864

[illegible]

Fletorja Zyrtare Viti 2022 – Numri 93



Fletorja Zyrtare  Viti 2022 – Numri 93

[illegible]

Fletorja Zyrtare		Viti 2022 – Numri 93
------------------	---	----------------------



Viti 2022 – Numri 93

[illegible]

Fletorja Zyrtare



Viti 2022 – Numri 93

[illegible]

Fletorja Zyrtare



Viti 2022 – Numri 93

[illegible]

Fletorja Zyrtare



Viti 2022 – Numri 93

[illegible]

Fletorja Zyrtare Viti 2022 – Numri 93



Viti 2022 – Numri 93

[illegible]

Fletorja Zyrtare Viti 2022 – Numri 93



Viti 2022 – Numri 93

[illegible]

Fletorja Zyrtare



Viti 2022 – Numri 93

[illegible]

Fletorja Zyrtare Viti 2022 – Numri 93



Fletorja Zyrtare  Viti 2022 – Numri 93

[illegible]

Page | 11874

[illegible]

Page | 11875

[illegible]

Fletorja Zyrtare



Viti 2022 – Numri 93

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

Fletorja Zyrtare Viti 2022 – Numri 93



Fletorja Zyrtare  Viti 2022 – Numri 93

[illegible]

Fletorja Zyrtare Viti 2022 – Numri 93



Fletorja Zyrtare  Viti 2022 – Numri 93

[illegible]

1. Çmimi sipas VKM nr.89, date 03.02.2016 - Per miratimin e hartes se vleres se tokes ne Republiken e Shqiperise

1. Çmimi sipas VKM nr.89, date 03.02.2016 - Per miratimin e
hukës së fshes në të cilën në Durrës dhe në Shkëmbin

4,011

2. Çmimi sipas Vendimit nr.138, dt. 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërbimit të pasurive pronë private që shpronësohet, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik".

Mbeshtetur në shkresën e ASHK Krujë nr. 1784/1 dt. 24.09.2021 dhe nr. 1784/2 dt. 28.09.2021, protokolluar në FSHZH me nr. 659/2 dt. 24.09.2021 dhe nr. 659/3 dt. 29.09.2021, çmimi mesatar i shit-blesjeve për objekte banimi për tremujorin paraardhës (Qeshor-Gusht-Shator 2021), Bashkia Krujë, për Z.K. 8621, është 47427 lekë/m²

8621, 8622, 8623, 8624, 8625, 8626, 8627, 8628, 8629, 8630, 8631, 8632, 8633, 8634, 8635, 8636, 8637, 8638, 8639, 8640, 8641, 8642, 8643, 8644, 8645, 8646, 8647, 8648, 8649, 8650, 8651, 8652, 8653, 8654, 8655, 8656, 8657, 8658, 8659, 8660, 8661, 8662, 8663, 8664, 8665, 8666, 8667, 8668, 8669, 8670, 8671, 8672, 8673, 8674, 8675, 8676, 8677, 8678, 8679, 8680, 8681, 8682, 8683, 8684, 8685, 8686, 8687, 8688, 8689, 8690, 8691, 8692, 8693, 8694, 8695, 8696, 8697, 8698, 8699, 8700, 8701, 8702, 8703, 8704, 8705, 8706, 8707, 8708, 8709, 8710, 8711, 8712, 8713, 8714, 8715, 8716, 8717, 8718, 8719, 8720, 8721, 8722, 8723, 8724, 8725, 8726, 8727, 8728, 8729, 8730, 8731, 8732, 8733, 8734, 8735, 8736, 8737, 8738, 8739, 8740, 8741, 8742, 8743, 8744, 8745, 8746, 8747, 8748, 8749, 8750, 8751, 8752, 8753, 8754, 8755, 8756, 8757, 8758, 8759, 8760, 8761, 8762, 8763, 8764, 8765, 8766, 8767, 8768, 8769, 8770, 8771, 8772, 8773, 8774, 8775, 8776, 8777, 8778, 8779, 8780, 8781, 8782, 8783, 8784, 8785, 8786, 8787, 8788, 8789, 8790, 8791, 8792, 8793, 8794, 8795, 8796, 8797, 8798, 8799, 8800, 8801, 8802, 8803, 8804, 8805, 8806, 8807, 8808, 8809, 8810, 8811, 8812, 8813, 8814, 8815, 8816, 8817, 8818, 8819, 8820, 8821, 8822, 8823, 8824, 8825, 8826, 8827, 8828, 8829, 8830, 8831, 8832, 8833, 8834, 8835, 8836, 8837, 8838, 8839, 8840, 8841, 8842, 8843, 8844, 8845, 8846, 8847, 8848, 8849, 8850, 8851, 8852, 8853, 8854, 8855, 8856, 8857, 8858, 8859, 8860, 8861, 8862, 8863, 8864, 8865, 8866, 8867, 8868, 8869, 8870, 8871, 8872, 8873, 8874, 8875, 8876, 8877, 8878, 8879, 8880, 8881, 8882, 8883, 8884, 8885, 8886, 8887, 8888, 8889, 8890, 8891, 8892, 8893, 8894, 8895, 8896, 8897, 8898, 8899, 8900, 8901, 8902, 8903, 8904, 8905, 8906, 8907, 8908, 8909, 8910, 8911, 8912, 8913, 8914, 8915, 8916, 8917, 8918, 8919, 8920, 8921, 8922, 8923, 8924, 8925, 8926, 8927, 8928, 8929, 8930, 8931, 8932, 8933, 8934, 8935, 8936, 8937, 8938, 8939, 8940, 8941, 8942, 8943, 8944, 8945, 8946, 8947, 8948, 8949, 8950, 8951, 8952, 8953, 8954, 8955, 8956, 8957, 8958, 8959, 8960, 8961, 8962, 8963, 8964, 8965, 8966, 8967, 8968, 8969, 8970, 8971, 8972, 8973, 8974, 8975, 8976, 8977, 8978, 8979, 8980, 8981, 8982, 8983, 8984, 8985, 8986, 8987, 8988, 8989, 8990, 8991, 8992, 8993, 8994, 8995, 8996, 8997, 8998, 8999, 9000, 9001, 9002, 9003, 9004, 9005, 9006, 9007, 9008, 9009, 9010, 9011, 9012, 9013, 9014, 9015, 9016, 9017, 9018, 9019, 9020, 9021, 9022, 9023, 9024, 9025, 9026, 9027, 9028, 9029, 9030, 9031, 9032, 9033, 9034, 9035, 9036, 9037, 9038, 9039, 9040, 9041, 9042, 9043, 9044, 9045, 9046, 9047, 9048, 9049, 9050, 9051, 9052, 9053, 9054, 9055, 9056, 9057, 9058, 9059, 9060, 9061, 9062, 9063, 9064, 9065, 9066, 9067, 9068, 9069, 9070, 9071, 9072, 9073, 9074, 9075, 9076, 9077, 9078, 9079, 9080, 9081, 9082, 9083, 9084, 9085, 9086, 9087, 9088, 9089, 9090, 9091, 9092, 9093, 9094, 9095, 9096, 9097, 9098, 9099, 9100, 9101, 9102, 9103, 9104, 9105, 9106, 9107, 9108, 9109, 9110, 9111, 9112, 9113, 9114, 9115, 9116, 9117, 9118, 9119, 9120, 9121, 9122, 9123, 9124, 9125, 9126, 9127, 9128, 9129, 9130, 9131, 9132, 9133, 9134, 9135, 9136, 9137, 9138, 9139, 9140, 9141, 9142, 9143, 9144, 9145, 9146, 9147, 9148, 9149, 9150, 9151, 9152, 9153, 9154, 9155, 9156, 9157, 9158, 9159, 9160, 9161, 9162, 9163, 9164, 9165, 9166, 9167, 9168, 9169, 9170, 9171, 9172, 9173, 9174, 9175, 9176, 9177, 9178, 9179, 9180, 9181, 9182, 9183, 9184, 9185, 9186, 9187, 9188, 9189, 9190, 9191, 9192, 9193, 9194, 9195, 9196, 9197, 9198, 9199, 9200, 9201, 9202, 9203, 9204, 9205, 9206, 9207, 9208, 9209, 9210, 9211, 9212, 9213, 9214, 9215, 9216, 9217, 9218, 9219, 9220, 9221, 9222, 9223, 9224, 9225, 9226, 9227, 9228, 9229, 9230, 9231, 9232, 9233, 9234, 9235, 9236, 9237, 9238, 9239, 9240, 9241, 9242, 9243, 9244, 9245, 9246, 9247, 9248, 9249, 9250, 9251, 9252, 9253, 9254, 9255, 9256, 9257, 9258, 9259, 9260, 9261, 9262, 9263, 9264, 9265, 9266, 9267, 9268, 9269, 9270, 9271, 9272, 9273, 9274, 9275, 9276, 9277, 9278, 9279, 9280, 9281, 9282, 9283, 9284, 9285, 9286, 9287, 9288, 9289, 9290, 9291, 9292, 9293, 9294, 9295, 9296, 9297, 9298, 9299, 9300, 9301, 9302, 9303

1	Apartament	47,427
---	------------	--------

2. Mbeshtetur në shkresën e EKB nr. 3332/1 datë 27.09.2021, protokolluar në FSHZH me nr. 2904/1 dt. 29.09.2021, Çmimi sipas UKM nr.3, datë 28.12.2019 për Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të Banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016, çmimi është 32,510 lekë/m².

sipas UKM nr.3, date 28.12.2019 per Miratimin e kostos
macetora ta ndalimit ta Banacia nga Enti Kombetar i

1 Njesi sherbimi *

32,510

* Per Njesite e Sherbimit, eshte zbritur amortizimi i objektit ne mbeshtetje te ligjit nr. 8438, date 28.12.1998 (i perditesuar), Neni 22, pika 3.



UDHËZIM
Nr. 16, datë 15.6.2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 31, DATË
26.12.2013, “PËR EMETIMIN NGA
QEVERIA E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË TË OBLIGACIONEVE
NË FORMË REGJISTRIMI”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe të neneve 5 dhe 20, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 31, datë 26.12.2013, “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistrimi”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime, si më poshtë:

Neni 1

Pas pikës 4, të nenit 1, shtohet pika 5 me përmbajtje si vijon:

“5. Blerja mbrapsht (procedura e riblerjes) është metoda që përdoret për një menaxhim aktiv të portofolit të borxhit publik, me qëllim mitigimin e riskut të rifinancimit dhe përmirësimin e profilit të borxhit të brendshëm.”.

Neni 2

Pika 1, e nenit 3, ndryshohet si vijon:

“1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si përfaqësuese e qeverisë së Republikës së Shqipërisë në emetimin e titujve shtetërorë, për çdo tremujor, jo më vonë se 15 ditë para fillimit të tremujorit

përkatës, publikon kalendarin e emetimit të llojeve të ndryshme të obligacioneve. Në këtë kalendar, përcaktohet frekuenca e zhvillimit të ankandeve, datat dhe shumat indikative të emetimit sipas afateve të maturimit të obligacioneve. Në rastin e riblerjes, përcaktohet:

- a) ISIN që do të blihet mbrapsht (riblerje);
- b) Shuma që pritët të blihet para kohe;
- c) Data e ankandit;
- d) Data e shlyerjes.”.

Neni 3

Pas pikës 1, të nenit 5, shtohet pika 1.1 me përmbajtje si vijon:

“1/1. Për ankandet e riblerjes, njoftimi përmban elementet e mëposhtme:

- a) Numrin unik (ISIN) të titullit që do të blihet mbrapsht;
- b) Shumën që do të blihet mbrapsht;
- c) Datën e shlyerjes së ankandit;
- d) Tipin e ankandit (uniformë apo më shumë çmime).”.

Neni 4

Pas pikës 1, të nenit 12, shtohet pika 1.1 me përmbajtje si vijon:

“1/1. Për ankandet e riblerjes, Ministria vendos për nivelin e normës së interesit (*yield-it*) të pranuar në bazë të të cilit përcaktohen fituesit e ankandit të riblerjes (shitësit e obligacioneve).”.

Neni 5

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj



Ishte	Bëhet (ndryshimet)
Neni 3, pika 1 Kalendari i emetimit të Obligacioneve 1. Ministria e Financave si përfaqësuese e qeverisë së Republikës së Shqipërisë në emetimin e titujve shtetëror, për çdo tremujor, jo më vonë se 15 ditë para fillimit të tremujorit përkatës, publikon kalendarin e emetimit të llojeve të ndryshme të obligacioneve. Në këtë kalendar, përcaktohet frekuenca e zhvillimit të ankandeve, datat dhe shumat indikative të emetimit sipas afateve të maturimit të obligacioneve.	Neni 1/1, pika 5 shtohet Blerja mbrapsht (procedura e riblerjes) është metoda që përdoret për një menaxhim aktiv të portofolit të borxhit publik, me qëllim mitigimin e riskut të rifinancimit dhe përmirësimin e profilit të borxhit të brendshëm. Neni 3, pika 1 Kalendari i emetimit të obligacioneve 1. Ministria e Financave si përfaqësuese e qeverisë së Republikës së Shqipërisë në emetimin e titujve shtetëror, për çdo tremujor, jo më vonë se 15 ditë para fillimit të tremujorit përkatës, publikon kalendarin e emetimit të llojeve të ndryshme të obligacioneve. Në këtë kalendar, përcaktohet frekuenca e zhvillimit të ankandeve, datat dhe shumat indikative të emetimit sipas afateve të maturimit të obligacioneve. Në rastin e riblerjes, përcaktohet: a) ISIN që do të blihet mbrapsht (riblerje); b) Shuma që pritet të tërhiqet para kohe; c) Data e ankandit; d) Data e shlyerjes. Neni 5, pika 1/1 shtohet 1/1. Për ankandet e riblerjes, njoftimi përmban elementet e mëposhtme: a) Numrin unik (ISIN) të titullit që do të blihet mbrapsht; b) Shumën që do të blihet mbrapsht; c) Datën e shlyerjes së ankandit; d) Tipi i ankandit (uniformë apo më shumë çmime). Neni 12, pika 1/1 shtohet 1/1. Për ankandet e riblerjes, Ministria vendos për nivelin e normës së interesit (<i>yield-it</i>) të pranuar në bazë të të cilit përcaktohen fituesit e ankandit të riblerjes (shitësit e obligacioneve).

**URDHËR**

Nr. 115, datë 6.6.2022

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR KËRKESAT, PËRMBAJTJEN E
REGJISTRIT DHE PROCEDURAT E
REGJISTRIMIT, ÇREGJISTRIMIT OSE
NDRYSHIMIT TË TË DHËNAVE NË
REGJISTRIN E AVIONËVE CIVILË TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të pikës 6, të nenit 30, të ligjit 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar (aneksi 7), nënshkruar më 7 dhjetor 1944 në Çikago, miratuar me dekret të Presidentit nr. 7438, datë 1.12.1990, “Për aderimin në Konventën për Aviacionin Civil (ICAO) dhe në protokollin për tekstin autentik tregjuhësh të kësaj konvente”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për kërkesat, përmbajtjen e regjistrit dhe procedurat e regjistrimit, çregjistrimit ose ndryshimit të të dhënave, në Regjistrin e Avionëve Civilë të Republikës së Shqipërisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe për zbatimin e këtij urdhri, zbatimin e këtij urdhri.

3. Urdhri i ministrit nr. 113, datë 12.10.2012, “Për miratimin e rregullore për regjistrimin e avionëve civilë shqiptarë”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**

RREGULLORE

**PËR KËRKESAT, PËRMBAJTJEN E
REGJISTRIT DHE PROCEDURAT E
REGJISTRIMIT, ÇREGJISTRIMIT OSE
NDRYSHIMIT TË TË DHËNAVE NË
REGJISTRIN E AVIONËVE CIVILË TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**KAPITULLI I
TË PËRGJITHSHME****Neni 1****Qëllimi dhe fusha e zbatimit**

1. Kjo rregullore përcakton elementet e përmbajtjes së regjistrit, kërkesat dhe procedurën e regjistrimit, çregjistrimit ose ndryshimit të të dhënave të regjistruara në Regjistrin e Avionëve civilë të Republikës së Shqipërisë, karakteristikat që duhet të plotësojë shenja e regjistrimit të avionit dhe elementet e certifikatës së regjistrimit dhe çregjistrimit të avionit.

2. Regjistri i Avionëve Civilë të Republikës së Shqipërisë mbahet nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

Neni 2**Përkufizime**

Në kuptim të kësaj rregulloreje, me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

1. “**AAC**” është Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar, sipas përcaktimeve në nenin 8, të ligjit 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, përgjegjës për administrimin e Regjistrit të Avionëve Civilë Shqiptarë dhe të çdo regjistri tjetër të aviacionit civil.

2. “**Aeroplan**” është një mjet fluturues me motor, më i rëndë se ajri, forca ngritëse me ajër e të cilit derivon nga veprimet aerodinamike mbi sipërfaqet që qëndrojnë të pandryshuara nën kushte të caktuara të fluturimit.

3. “**Agjenci operimi ndërkombëtare**” është një agjenci e natyrës së përcaktuar në nenin 77 të Konventës së Çikagos.

4. “**Airship**” është një avion me motor, më i lehtë se ajri.

5. “**Autoriteti regjistruar i shenjave të përgjithshme**” është autoriteti që mban regjistrin jokombëtar ose, aty ku është e përshtatshme, pjesa



në të cilin avionët e një agjencie ndërkombëtare operuese regjistrohen.

6. “**Avion**” është një mjet, i cili mund të qëndrojë në atmosferë nga kundërveprimi i ajrit, përveç kundërveprimit të ajrit kundrejt sipërfaqes së tokës. Ky term përfshin xhiroplanët; helikopterët; balonat me motor; deltaplanët ose mjetet fluturuese pa motor (gliders); hidroplanët; aeroplanët; balonat me fluturim të lirë dhe ato të kontrolluara/të lidhura me tokën; deltaplanët ose mjetet fluturuese, që manovrohen nga toka; parashutat; modelet fluturuese; pajisjet sportive fluturuese, si dhe mjetet e tjera fluturuese, të cilat mund të përdorin hapësirën ajrore (neni 3, Klasifikimi i avionit).

7. “**Avion më i rëndë se ajri**” është një mjet ajror që derivon forcën e tij ngritëse në fluturim, kryesisht nga forcat aerodinamike.

8. “**Avion më i lehtë se ajri**” është një mjet që kryesisht mbahet në fluturim nga lundrimi i tij në ajër.

9. “**Avionë civilë shqiptarë**” janë të gjithë avionët civilë që regjistrohen në Regjistrin e Avionëve Civilë Shqiptarë, përveç atyre të shërbimeve shtetërore.

10. “**Avion i pilotuar në distancë (RPA)**” është një avion pa pilot, i cili pilotohet nga një stacion pilotimi i largët.

11. “**Balonë**” është një avion pa motor më i lehtë se ajri.

12. “**Glider**” është një avion pa motor, më i rëndë se ajri, që mbahet kryesisht nga reaksionet aerodinamike në sipërfaqet që qëndrojnë të fiksuara në kushtet e dhëna të fluturimit.

13. “**Helikopter**” është një mjet ajror më i rëndë se ajri që mbahet në fluturim, kryesisht nga reagimi i ajrit në një apo më shumë helika të tij në akse vertikale që marrin xhiro nga motori.

14. “**ICAO**” është Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil.

15. “**Marrëveshje shumëpalëshe**” është marrëveshja shumëpalëshe, shtojcat dhe Protokollin i saj për krijimin e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ZPEA), e ratifikuar me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së

Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe misionit administrativ të përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, “Për krijimin e një zone të përbashkët të Aviacionit Evropian”, në vijim referuar si “marrëveshja shumëpalëshe”.

16. “**Marrëveshja e qirasë**” nënkupton një marrëveshje me të cilën një person i jep të drejtën për posedim ose kontroll për një periudhë kohore të përcaktuar, të një avioni ose të një mjeti fluturues (me ose pa të drejtën e blerjes) një personi tjetër (qiramarrësi) në kthim për arkëtim ose pagesa të tjera, dhe termat “qira”, “nënqira”, “nënligjore” dhe “nënqiramarrës” do të interpretohen në përputhje me rrethanat dhe kur përdoret termi “qira”, ai përfshin një “nën, ku përdoret termi “qiradhënësi”, do të përfshijë një “nënligjor” dhe ku përdoret termi “qiramarrës”, ai duhet të përfshijë një “nënqiramarrës”.

17. “**Marrëveshje e qirasë së thatë (Dry Lease)**” është marrëveshja e qirasë së avionëve pa personelin dhe sigurimin ndërmjet sipërmarrjeve, sipas së cilës avioni operohet nën AOC-në e qiramarrësit.

18. “**Marrëveshje e qirasë së njomë (Wet Lease)**” është marrëveshja e qirasë së avionëve së bashku me personelin dhe sigurimin ndërmjet sipërmarrjeve, sipas së cilës avioni operohet nën AOC-në e qiramarrësit.

19. “**Material zjarrdurues**” është një material në gjendje të durojë nxehtësinë ashtu si ose më mirë se çeliku, kur dimensionet në të dyja rastet janë të duhurat për qëllimin e caktuar.

20. “**Mbajtësi i avionit**” është pronari i avionit, i cili operon avionin dhe ka aplikuar për regjistrimin e tij ose operatorin jopronar të avionit, i cili ka marrë me qira avionin për përdorim.

21. “**Orintopter**” është një mjet ajror më i rëndë se ajri që mbahet në fluturim kryesisht nga reagimet e ajrit në planet në të cilat aplikohet një lëvizje “përplasje e krahëve”.

22. “**Operator**” është personi që ka të drejtë të operojë avionin si pronar ose sipas një marrëveshjeje operimi.

23. “**Rotorkraft**” është një mjet ajror më i rëndë se ajri, që mbahet në fluturim nga një reagim i ajrit në një ose më shumë helika.

24. “**Regjistrues**” është personi në emër të të cilit një avion është regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Avionëve.



25. “**Shteti i regjistrit**” është ai shtet në regjistrin e të cilit është regjistruar avioni.

26. “**Shenja e përgjithshme**” është një shenjë e caktuar nga ICAO për Autoritetin e Regjistruar të Shenjave të Përgjithshme, që regjistron avionë nga një agjenci operuese ndërkombëtare, përveç regjistrimit mbi baza kombëtare;

Të gjithë avionët e një agjencie operuese ndërkombëtare, që janë regjistruar, përveç regjistrimit në baza kombëtare, do të mbajnë të njëjtën shenjë të përgjithshme.

27. “**Xhiroplan**” është një avion më i rëndë se ajri, që mbahet në fluturim nga reagimi i ajrit në një apo me shumë helika, të cilat rrotullohen lirisht në akse vertikale.

KAPITULLI II KLASIFIKIMI I MJETEVE AJRORE

Neni 3 Kategorizimi i avionëve

1. Avionët do të klasifikohen në avionë më të lehtë se ajri dhe avionë më të rëndë se ajri.

1.1 Avionët më të lehtë se ajri klasifikohen në avionë më të lehtë se ajri pa motor dhe avionë më të lehtë se ajri me motor.

1.1.1 Avionët më të lehtë se ajri pa motor klasifikohen, përkatësisht në:

- a) balona të lira sferike dhe josferike;
- b) balon i lidhur sferike dhe josferike¹.

1.1.2 Avionët më të lehtë se ajri me motor klasifikohen në airship me motor:

- a) airship i ngurtë;
- b) airship gjysmë i ngurtë;
- c) airship jo i ngurtë.

1.2 Avionët më të rëndë se ajri klasifikohen në avionë më të rëndë se ajri pa motor (planer-glider, kite²) dhe avionë më të rëndë se ajri me motor.

1.2.1 Avionët më të rëndë se ajri pa motor klasifikohen, përkatësisht në:

- a) planer toke;
- b) planer deti³.

¹ Zakonisht i projektuar si *kite balloon*.

² Vetëm për qëllim plotësimi.

³ “Lundruar” ose “varkë” mund të shtohet sipas rastit, për mjetet që ulen në det dhe amfib, të përmendura edhe te pika 1.2.2.

1.2.2 Avionët më të rëndë se ajri me motor klasifikohen, përkatësisht në:

- a) aeroplan (toke⁴, deti, aeroplan amfib);
- b) rotorcraft, të cilët janë:
 - b1) xhiroplan (toke, deti, amfib);
 - b2) helikopter (toke, deti, amfib);
- c) ornitopeter (toke, deti, amfib).

2. Një avion i cili synon të operohet pa pilot në bord do të klasifikohet më tej si pa pilot.

3. Avionët pa pilot përfshijnë balona të lira pa pilot dhe avionë të pilotuar në distancë.

KAPITULLI III REGJISTRI I AVIONËVE CIVILË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 4 Regjistrimi i avionit

1. Autoriteti i Aviacionit Civil do të mbajë Regjistrin e Avionëve Civilë të Republikës së Shqipërisë, të përditësuar, që përmban informacion për çdo avion të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, si dhe informacionin e regjistruar në certifikatën e regjistrimit të avionit e parashikuar në nenin 19 të kësaj rregulloreje. Regjistri i balonave pa pilot do të përmbajë datën, kohën dhe vendin e lëshimit, tipin e balonës dhe emrin e operatorit.

2. Regjistri mbahet në formë libri (Libri i Regjistrimit) ose elektronikisht.

3. Në rastin e çregjistrimit të avionit, certifikata e çregjistrimit do të lëshohet sipas parashikimeve në nenin 20 të kësaj rregulloreje.

4. Autoriteti i Aviacionit Civil publikon Regjistrin e Avionëve Civilë të RSH-së, si dhe e përditëson periodikisht atë, pa anashkaluar dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 5 Llojet e regjistrimit

1. Veprimet në regjistër janë, por nuk kufizohen, në sa më poshtë:

- a) hyrja/regjistrimi i avionëve;
- b) fshirja/çregjistrimi i avionëve;
- c) ndryshim i pronarit të avionit;

⁴ Përfshin avionë të pajisur me mjet ulës si të skive, për mjetet që ulen në tokë, të përmendura edhe në pikën 1.2.2.



d) ndryshime të të dhënave ekzistuese.

2. Kjo rregullore përcakton dokumentacionin që duhet t'i bashkëngjitet kërkesës për secilin prej veprimeve që do të kryhen në regjistër.

Neni 6

Përmbajtja e Regjistrimit të Avionëve Civilë të Republikës së Shqipërisë

1. Në regjistrin e Avionëve Civilë të Republikës së Shqipërisë do të regjistrohen të gjithë avionët që janë subjekt i kësaj rregulloreje.

2. Regjistri duhet të përmbajë të dhënat e certifikatës së regjistrimit apo të çregjistrimit, si edhe sa më poshtë vijon:

- a) datën e regjistrimit;
- b) emrin e prodhuesit të avionit dhe adresën;
- c) datën e prodhimit dhe numrin e serisë së avionit;
- d) tipin dhe modelin e avionit;
- e) emrin, mbiemrin dhe adresën e mbajtësit të avionit (pronari ose operatori);
- f) shenjën e regjistrimit;
- g) vendimin e Gjykatës për statusin e pronësisë së mjetit (kur është i zbatueshëm);
- h) datën dhe shkaktuesin e çregjistrimit të avionit nga regjistri;
- i) të dhënat e ndryshuara;
- j) emri, mbiemri, firma e inspektorit që plotëson regjistrin;
- k) emri, mbiemri, firma e marrësit të certifikatës së regjistrimit të avionit ose të çregjistrimit të avionit.

Neni 7

Shenja e shtetësisë, e përgjithshme dhe e regjistrimit

1. Shenja e shtetësisë shqiptarë ose e përgjithshme dhe shenja e regjistrimit do të përbëhen nga një grup karakteresh.

2. Shenja e shtetësisë ose shenja e përgjithshme i paraprin shenjës së regjistrimit. Kur karakteri i parë i shenjës së regjistrimit është një shkronjë ajo paraprihet nga një vizë.

3. Shenja e shtetësisë do të zgjidhet nga seria e simboleve kombëtare të përfshira në shenjat e thirrjeve radio të alokuara për Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit:

a) caktimi i shenjës për AAC-në bëhet nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil;

b) shenjat e shtetësisë dhe emblemat kombëtare që i njoftohen ICAO-s dhe shenjat e përgjithshme të alokuara nga ICAO-ja gjenden në listën e shenjave kombëtare të avionëve, emblemave kombëtare dhe shenjave të përgjithshme, që publikohet në faqen zyrtare të ICAO-s.

4. Shenja e shtetësisë së avionëve civilë të Republikës së Shqipërisë është e regjistruar në ICAO dhe njihet prej saj. Avionët shqiptarë mbajnë shenjën “ZA”, të shtetësisë shqiptare dhe një shenjë të veçantë regjistrimi, që i jepet çdo avioni kur regjistrohet.

5. Shenja e regjistrimit përbëhet nga shkronja, numra ose një kombinim i të dyjave dhe do të caktohet nga shteti i regjistrimit apo nga Autoriteti Regjistrues i Shenjave të Përgjithshme. Për avionët për të cilët Shqipëria është shteti i regjistrimit, shenja jepet nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

6. Kur shkronjat përdoren për shenjën e regjistrimit, kombinimet nuk mund të përdoren nëse ato mund të ngatërrohen me kombinimet me pesë shkronja të përdorura në pjesën II, të Kodit Ndërkombëtar të Sinjaleve, kombinimet me tri shkronja që fillojnë me Q të përdorur në Kodin Q, dhe me sinjalin e shqetësimit SOS ose sinjale të tjera urgjente të ngjashme, për shembull XXX, PAN dhe TTT, referuar përcaktimeve në fuqi në rregulloret ndërkombëtare të telekomunikacionit.

Neni 8

Lloji i karaktereve për shenjat e përgjithshme, të shtetësisë dhe të regjistrimit

1. Shkronjat duhet të jenë shkronja të mëdha me shkronja romake pa zburime. Numrat do të jenë numra arabë pa zburime.

2. Gjerësia e çdo shkronjë apo numri (veç shkronjës I dhe numrit 1) dhe gjatësia e vijës ndarëse midis shenjës së shtetësisë dhe asaj të regjistrimit duhet të jenë sa dy të tretat e lartësisë së shkronjave dhe të numrave.

3. Karakteret dhe vijat do të formohen nga linja të forta dhe do të kenë një ngjyrë që dallon qartë me sfondin. Trashësia e linjave duhet të jetë një e gjashta e lartësisë së një karakteri.

4. Secili karakter duhet të ndahet nga ai që paraprin ose ndjek menjëherë, nga një hapësirë jo



më pak se një e katërta e gjerësisë së karakterit. Një vijë do të konsiderohet si karakter për këtë qëllim.

5. Shenja e shtetësisë dhe shenja e regjistrimit do të lyhen me bojë ose do të vendosen në avion me çdo mënyrë që siguron një qëndrueshmëri të afërt me bojën. Shenjat duhet të mbahen pastër dhe të dukshme në çdo kohë.

Neni 9

Vendosja dhe përmasat e shenjës së përgjithshme, të shtetësisë dhe të regjistrimit në avionët më të rëndë se ajri

1. *Krahët.* Në avionët më të rëndë se ajri, shenja e shtetësisë dhe shenja e regjistrimit që do të përdoren duhet të shkruhen në sipërfaqen e poshtme të strukturës së krahëve, në gjysmën e majtë të strukturës së poshtme, përveçse kur shtrihen në të gjithë sipërfaqen e strukturës së krahut. Aq sa është mundësia, shenjat duhet të baraslargohen nga skajet drejtuese të krahëve. Maja e sipërme e shkronjave dhe e numrave duhet të jetë në drejtim të skajit drejtues të krahut.

2. *Trupi i avionit (ose çdo strukturë e njëjtë) dhe sipërfaqja vertikale e bishtit.* Në avionët më të rëndë se ajri, shenjat ose do të vendosen në çdo anë të trupit të avionit ose në çdo strukturë të njëjtë mes sipërfaqes së krahëve dhe të bishtit ose në gjysmat e sipërme të sipërfaqeve vertikale të bishtit. Kur vendosen në një sipërfaqe të vetme vertikale të bishtit, ato duhet të shfaqen në të dyja anët. Kur ndodhet në sipërfaqet multivertikale të bishtit, ato duhet të shfaqen në anët e jashtme të sipërfaqeve të jashtme.

3. *Raste të veçanta.* Nëse një avion më i rëndë se ajri nuk i ka pjesët që korrespondojnë me ato të përmendura në pikat 2 dhe 3, atëherë shenjat duhet të shfaqen në një mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e avionit menjëherë.

4. Shkronjat dhe numrat e një shenje duhet të jenë të së njëjtës lartësi.

5. Madhësia e shenjës së shtetësisë “ZA” dhe e shenjës të regjistrimit, kur ato shkruhen në trupin e avionit dhe në sipërfaqen vertikale të bishtit, duhet të jenë të paktën 30 cm, ndërsa në sipërfaqen e krahëve të avionit duhet të jenë të paktën 50 cm.

6. Në rastet kur në avion nuk ka pjesët korresponduese të përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni ose, nëse pjesët janë shumë të vogla për të akomoduar shenjat me përmasat e përmendura

më lart, ato shkruhen në atë madhësi që përcakton AAC-ja, duke konsideruar nevojën për identifikim pa vështirësi.

Neni 10

Vendosja dhe përmasat e shenjës së përgjithshme, të shtetësisë dhe të regjistrimit në avionët më të lehtë se ajri

1. *Airship.* Shenjat në një airship duhet të shfaqen ose në trup ose në sipërfaqet e stabilizuesit. Kur shenjat shfaqen në trup, ato do të vendosen për së gjati në secilën anë të trupit dhe, gjithashtu, në sipërfaqen e sipërme të saj në mënyrë simetrike. Kur shenjat shfaqen në sipërfaqet e stabilizuesit, ato duhet të shfaqen në stabilizuesit horizontalë dhe në vertikalë; shenjat në stabilizuesin horizontal duhet të vendosen në gjysmën e djathtë të sipërfaqes së sipërme dhe në gjysmën e majtë të sipërfaqes së poshtme, me majat e shkronjave dhe numrat drejt skajit kryesor; shenjat në stabilizuesin vertikal duhet vendoset në secilën anë të gjysmës së poshtme të stabilizatorit, me shkronjat dhe numrat të vendosur horizontalisht.

2. *Balona sferike (përveç balonave pa pilot).* Shenjat duhet të shfaqen në dy vende diametralisht të kundërta. Ato duhet të vendosen pranë perimetrit maksimal horizontal të balonës.

3. *Balona josferike (përveç balonave pa pilot).* Shenjat duhet të shfaqen në secilën anë. Ato do të jenë të vendosura afër seksionit të tërthortë maksimal të balonës menjëherë mbi brezin e montimit ose mbi pikat e lidhjes të kabllave të mbajtjes së shportës.

4. *Avionë më të lehtë se ajri (përveç balonave pa pilot).* Shenjat anësore duhet të jenë të dukshme nga të dyja anët dhe nga toka.

5. *Balona pa pilot.* Shenjat duhet të shfaqen në pllakën e identifikimit, siç përshkruhet në nenin 12, të kësaj rregulloreje.

6. Shkronjat dhe numrat, në çdo grup të veçantë të shenjave, do të kenë të njëjtën lartësi. Lartësia e shenjave në avionët më të lehtë se ajri, përveç balonave pa pilot, duhet të jetë së paku 50 centimetra.

7. Përmasat e shenjave që lidhen me balonat pa pilot do të përcaktohen nga AAC-ja, duke marrë parasysh madhësinë e ngarkesës në të cilën është vendosur tabela e identifikimit.

8. *Raste të veçanta.* Kur avioni më i lehtë se ajri nuk ka pjesë në madhësi të mjaftueshme për të



akomoduar shenjat me përmasat e përmendura më lart në pikën 6, ato shkruhen në atë madhësi që përcakton AAC-ja, duke konsideruar nevojën për identifikim pa vështirësi.

Neni 11

Rezervimi i shenjës së regjistrimit

1. Shenja e regjistrimit mund të kërkohej paraprakisht ose në të njëjtën kohë me aplikimin për regjistrim të avionit.

2. Dokumentet që duhet të paraqiten për rezervimin e shenjës së regjistrimit janë:

- kërkesa e bërë nga pronari i avionit ose operatori jopronar;
- kopje të dokumentit të identitetit të aplikantit.

Neni 12

Pllaka e identifikimit

1. Në çdo avion duhet të vendoset një pllakë identifikuese, në të cilën të jenë të gdhendura shenja e shtetësisë dhe shenja e regjistrimit. Pllaka duhet të jetë prej metali të papërshkueshëm nga zjarri ose materiali tjetër zjarrdurues me veti të përshtatshme fizike.

2. Pllaka duhet të vendoset në trupin e avionit, në vend të dukshëm, afër hyrjes kryesore, ose:

a) në rastin e një balone pa pilot, të vendoset në mënyrë të dukshme në pjesën e jashtme të ngarkesës; dhe

b) në rastin e një avioni të pilotuar në distancë (RPA), të vendoset në një pozicion të dukshëm pranë hyrjes ose ndarjes kryesore ose e vendosur në mënyrë të dukshme në pjesën e jashtme të avionit, nëse nuk ka hyrje ose ndarje kryesore.

3. Dispozitat e këtij neni nuk do të zbatohen për balonat meteorologjike me pilot të përdorura ekskluzivisht për qëllime meteorologjike ose për balonat pa pilot pa ngarkesë.

Neni 13

Inspektimi fizik i avionit

1. Procesi i inspektimit fizik të avionit duhet të kryhet para lëshimit të certifikatës së regjistrimit të avionit në regjistër.

2. Gjatë inspektimit fizik do të kontrollohet shkrimi i shenjave të regjistrimit, sipas kërkesave të nenit 8 të kësaj rregulloreje.

3. Gjatë inspektimit fizik do të kontrollohet vendosja e pllakës identifikuese të avionit, sipas kërkesave të parashtruara në nenet 9 deri 13 të kësaj rregulloreje.

KAPITULLI III

REGJISTRIMI I AVIONËVE NË RACSH

Neni 14

Kushtet bazë për regjistrimin

1. Shteti i regjistrimit është ai shtet në regjistrin e të cilit është regjistruar avioni.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil mban Regjistrin e Avionëve Civilë të Republikës së Shqipërisë.

3. Një avion mund të regjistrohet në Shqipëri, sipas ligjeve të shtetit shqiptar dhe të gëzojë të gjitha të drejtat dhe privilegjet e një avioni shqiptar, kur zbatohen kërkesat e kësaj rregulloreje.

4. Avioni regjistrohet në Republikën e Shqipërisë vetëm nëse plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:

a) Nuk është i regjistruar në regjistrin e një shteti tjetër, pra:

i. të jetë i çregjistruar nga çdo regjistër i mëparshëm (nëse ka qenë në një të tillë); dhe

ii. për këtë rast, mbajtësi i avionit, të zotërojë aktin e çregjistrimit të avionit nga regjistri i mëparshëm dhe të dorëzojë një kopje të njëzuar me origjinalin, në AAC, për të kryer veprimet e regjistrimit të avionit.

b) Është në pronësinë:

i. e personave me shtetësi shqiptare, personave me shtetësi të një shteti anëtar të ZPEA-së, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, por që kanë leje qëndrimi të përhershme në Republikën e Shqipërisë;

ii. të një sipërmarrjeje, që ka vendin e saj kryesor të veprimtarisë në Republikën e Shqipërisë, me objekt kryesor të veprimtarisë transportin ajror;

iii. të një shoqërie të formuar në përputhje me ligjin e një shteti anëtar të Bashkimit Evropian ose të një shteti palë në marrëveshjen shumëpalëshe, regjistrimi i së cilës, administrata qendrore ose vendi kryesor i veprimtarisë ndodhet në atë shtet, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe;

iv. është marrë me qira të thatë nga një operator ajror i certifikuar nga AAC-ja.

5. Operatori i avionit mund të regjistrohet në regjistër në vend të pronarit, në rast se përmbush



kërkesat për regjistrimin, me përjashtim të pronësisë dhe përmbush kërkesat e nenit 16 pika 3 të kësaj rregulloreje.

Neni 15

Informacioni i operatorit

1. Kur avioni regjistrohet në regjistër nga pronari i avionit, ai konsiderohet si një operator. Nëse pronari paraqet një kërkesë për të regjistruar si operator të avionit dikë tjetër, kërkesa e paraqitur duhet të jetë konform detyrimeve të përfaqësimit, sipas ligjeve të shtetit shqiptar.

2. Nëse operatori është një person tjetër, përveç pronarit të avionit, hyrja e informacionit të operatorit kryhet në bazë të origjinalit ose të kopjes së vërtetuar të marrëveshjes së nënshkruar të qirasë ose dokumentit tjetër, mbi bazën e të cilit pronari transferon të drejta dhe detyrime tek operatori.

3. Regjistrimi i hyrjes ose i fshirjes së avionit nga regjistri do të kryhet me kërkesë të pronarit të avionit ose me kërkesë të operatorit jopronar të avionit në bazë të një autorizimi me shkrim të posaçëm të pronarit të avionit, i cili autorizon operatorin të kërkojë regjistrimin ose fshirjen e avionit nga regjistri.

Neni 16

Dokumentacioni për regjistrimin e avionëve civilë në regjistrin shqiptar

1. Hyrjet në regjistër lejohen vetëm në bazë të dokumenteve të hartuara në formën e përcaktuar për vlefshmërinë e tyre.

2. Hyrja bëhet në bazë të dokumentit origjinal ose një kopje të vërtetuar të origjinalit. Nëse origjinali i dokumentit është në dosjet zyrtare të një organi tjetër ose gjykate ose nëse ai është paraqitur në AAC në një rast tjetër, është e mjaftueshme të paraqitet një kopje e dokumentit e vërtetuar me origjinalin.

3. Avionët e importuar në Republikën e Shqipërisë dhe që janë pronësi të aplikuesit, gjithashtu, duhet të kenë një deklaratë të vetën doganore.

Neni 17

Aplikimi për regjistrimin e avionit

1. Kërkesa për regjistrimin e avionëve në Regjistrin e Avionëve Civilë të Republikës së Shqipërisë paraqitet nga mbajtësi i avionit (pronari operator ose operatori që ka marrë me qira në përdorim avionin).

2. Nëse një operator paraqet një kërkesë për regjistrimin e avionit në regjistër, kërkesa duhet të jetë e shoqëruar me autorizimin me shkrim të vërtetuar të pronarit të avionit, i cili autorizon operatorin të kryejë veprimet për regjistrimin e avionit në regjistër.

Neni 18

Dokumentacioni specifik për regjistrimin e avionit

1. Kërkesa për regjistrimin e avionit do të shoqërohet, me:

a) formularin e aplikimit të hartuar nga AAC-ja, për regjistrimin e avionit, ku jepet informacioni mbi prodhuesin, numrin serial, vitin e prodhimit dhe masën maksimale të ngritjes (MTOM), të plotësuar në konformitet me kërkesat e përcaktuara të kësaj rregulloreje;

b) kontratën e shitblerjes së avionit (rasti kur është pronar operator), ose kontratën e qirasë (kur operatori e ka marrë në përdorim avionin nga pronari);

c) Certifikatën e Eksportit (kur avioni vjen nga jashtë) dhe kjo certifikatë është e zbatueshme;

d) Certifikatën e Çregjistrimit (nëse ka qenë i regjistruar në një vend tjetër);

e) IDERA - Autorizim i parevokueshëm i kërkesës për çregjistrim dhe eksport (*Irrevocable De-Registration and Export Request Authorisation*) (nëse aplikohet një e tillë);

f) nëse avioni ka barrë siguruese ose pengu, dokumentin përkatës;

g) dokumentet e pronësisë dhe të çdoganimit të avionit në doganë, për rastet kur avioni është blerë jashtë vendit;

h) siguracionin e detyrueshëm.

2. AAC-ja shqyrton kërkesën e paraqitur nga mbajtësi i avionit për regjistrimin e avionit për përputhshmërinë e saj me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe i kthen përgjigje



zyrtare aplikuesit jo më vonë se 30 ditë pas dorëzimit të aplikimit për regjistrimin e avionit.

Neni 19

Certifikata e Regjistrimit

1. Certifikata e Regjistrimit të avionit duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe në anglisht. Në rast mospërputhje të përmbajtjes, gjuha shqipe prevalon.

2. Certifikata e Regjistrimit të një avioni do të ketë formën dhe elementet e paraqitura në shtojcën 1.

3. Operatori i avionit pajiset me një kopje të Certifikatës së Regjistrimit të lëshuar nga AAC-ja.

4. Origjinali i Certifikatës së Regjistrimit mbahet në bordin e çdo avioni.

5. Për çdo rast humbjeje nga pakujdesia apo dëmtim të Certifikatës së Regjistrimit ajo zëvendësohet nga AAC-ja mbi bazën e kërkesës direkt të operatorit të avionit.

6. Operatori i avionit përballon të gjitha shpenzimet për regjistrimin apo rinovimin e Certifikatës së Regjistrimit të avionit.

7. Certifikata e regjistrimit të një avioni nuk përbën leje për të fluturuar për atë avion. Me dhënien e një certifikate regjistrimi, aplikuesit i bëhet me dije se për të operuar avionin duhet të aplikojë për dokumentin, që vërteton vlefshmërinë ajrore të avionit ose lejen për të fluturuar, sipas rastit.

Neni 20

Çregjistrimi i avionëve nga regjistri

1. Avioni hiqet nga regjistri i avionëve civilë, kur:

a) nuk ka certifikatë të vlefshmërisë ajrore, të vlefshme gjatë tre vjetëve të fundit dhe pronari nuk mund ta marrë këtë certifikatë brenda afateve kohore të caktuara;

b) kërkohet nga pronari i avionit ose operatorit i avionit, i pajisur me dokumentin origjinal ose të noterizuar që shpreh dakordësinë e pronarit për çregjistrimin e avionit;

c) nuk përmbushen më kërkesat e parashikuara në nenin 30, të ligjit 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”;

ç) ka humbur dhe nuk ka informacion për vendndodhjen e tij prej tre muajsh dhe operacionet e kërkim-shpëtimit kanë përfunduar.

d) është i çmontuar ose i shkatërruar plotësisht.

2. Nëse kërkesa për çregjistrim bëhet nga operatori i avionit (mbajtësi i avionit) jopronar, AAC-ja kërkon konfirmimin me shkrim të pronarit të mjetit, lidhur me kërkesën e bërë për çregjistrimin e mjetit nga RACSH-ja.

3. AAC-ja kërkon dhe merr në dorëzim nga kërkuesi për çregjistrim, Certifikatën Origjinale të Regjistrimit të Avionit dhe të gjitha certifikatat e tjera origjinale të lidhura me mjetin, të lëshuara nga AAC-ja.

4. Para çregjistrimit AAC-ja kërkon deklaratë mbi ekzistencën e ndonjë barre siguruese mbi mjetin. Në të gjitha rastet, përpara fshirjes nga regjistri, njoftohet për situatën edhe personi për të cilin është lënë pengu (nëse ka një të tillë). Njoftimi bëhet zyrtarisht nga AAC-ja. Në rast të mosdijes së adresës, njoftimi bëhet me mjete publike.

5. Në rastin e çregjistrimit, zbatohen parashikimet për IDERA-n, nëse një IDERA është regjistruar për këtë mjet në AAC, sipas Konventës së *Cape Town*, duke u kryer çregjistrimi i saj sipas rastit;

6. Kur AAC-ja nis një iniciativë për çregjistrimin e avionit nga regjistri dhe nëse mbajtësi i avionit është operatori jopronar, AAC-ja duhet të njoftojë pronarin e avionit në lidhje procedurën e çregjistrimit të mjetit, shoqëruar me shkakun e çregjistrimit.

7. Në rastet kur adresa e pronarit nuk është e saktë ose njoftimi kthehet mbrapa, njoftimi bëhet me mjete publike.

8. Mbajtësit të avionit i lihet 10 ditë kohë pas marrjes së njoftimit për të paraqitur kundërshtimet e veta.

9. Në rast të çregjistrimit, AAC-ja lëshon certifikatë çregjistrimi, e cila do të ketë formën dhe elementet e paraqitura në shtojcën 2.

10. Certifikata e Çregjistrimit të avionit duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe në anglishte. Në rast mospërputhje të përmbajtjes, gjuha shqipe prevalon.



Neni 21

Dokumentet e kërkuara për çregjistrim

1. Pronari i avionit të regjistruar në Regjistrin e Avionëve të RSH-së mund të aplikojë për çregjistrim të avionit.

Dokumentet që kërkohen për çregjistrim janë:

- kërkesa e plotësuar dhe nënshkruar nga pronari i regjistruar;
- kopja e njëzuar e dokumentit të identitetit të nënshkruesit;
- origjinal i Certifikatës shqiptare të Regjistrimit të avionit;
- deklaratë mbi çdo barrë siguruese mbi mjetin.

2. Kur kërkesa për çregjistrim inicohet nga operatori, ajo nënshkruhet nga operatori dhe krahas dokumenteve të përshkruara në pikën 1, paraqitet edhe autorizimi nga pronari i avionit për çregjistrimin.

3. Në rastet kur çregjistrimi ndodh për shkak se avioni konsiderohet i shkatërruar dhe nuk mund të funksionojë më si një mjet, nevojitet, gjithashtu, që krahas kërkesës së plotësuar dhe të nënshkruar nga pronari ose operatori i regjistruar, AAC-ja, nëpërmjet inspektorëve përgjegjës për sigurinë në operim, të verifikojë gjendjen e avionit dhe të deklarohet mbi funksionalitetin e tij.

4. Në rastet kur avioni ka humbur, nevojitet, gjithashtu, që krahas kërkesës së plotësuar dhe të nënshkruar nga pronari ose operatori i regjistruar, të disponohet një dokument që vërteton humbjen, të lëshuar nga organet kompetente.

Neni 22

Ndryshimet në Regjistrin e Avionëve Civilë

1. Për çdo ndryshim në të dhënat e regjistrimit, mbajtësi i certifikatës së regjistrimit të avionit duhet

të njoftojë AAC-në për të bërë ndryshimet e nevojshme në regjistër dhe në certifikatë.

2. Pas vlerësimit të evidencave për vërtetësinë e ndryshimeve, AAC-ja, sipas rastit, udhëzon mbi ndryshimet e nevojshme në regjistër dhe në lëshimin e certifikatës së ndryshuar të regjistrimit të avionit.

3. Ndryshimet në regjistër dhe lëshimi i certifikatës së ndryshuar të regjistrimit kryhet kundrejt pagesës, nëse është e zbatueshme.

KAPITULLI IV DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 23

Të përgjithshme

Parashikimet e kësaj rregulloreje nuk do të zbatohen për balonat me pilot të meteorologjisë të përdorura ekskluzivisht për qëllime meteorologjike ose për balonat pa pilot pa ngarkesë.

Neni 24

Afatet kalimtare

1. Pronarët e avionëve më të lehtë se ajri, të cilët nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në kapitullin III të kësaj Rregulloreje, në lidhje me provën e pronësisë, mund të ushtrojnë të drejtën për të regjistruar një avion në Regjistër, vetëm nëse regjistrimi do të shoqërohet me një deklaratë personale, me të cilën aplikanti nën përgjegjësinë personale deklaron se është pronar i avionit.

2. Në të gjitha rastet, detyrimi për paraqitjen e Deklaratës Doganore për mjetin është i pashmangshëm.



SHTOJCA 1
CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT

*	REPUBLIKA E SHQIPËRISË/REPUBLIC OF ALBANIA Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/Ministry of Infrastructure and Energy AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL/CIVIL AVIATION AUTHORITY CERTIFIKATË REGJISTRIMI/ CERTIFICATE OF REGISTRATION	*
1. Shenja e shtetësisë ose e përgjithshme dhe shenja e regjistrimit/ Nationality or common mark and registration mark	2. Prodhuesi dhe përcaktimi i prodhuesit të avionit/Manufacturer and manufacturer's designation of aircraft	3. Numri serial i avionit/ Aircraft serial no.
4a. Lëshuar për/Issued to (emri i mbajtësit të certifikatës/name of certificate holder)		
Baza e regjistrimit/Basis of registration (shëno njërin): _ pronësi mbi avionin/ownership of aircraft _ operator i avionit/operator of aircraft _ tjetër/other (shpjego):.....		
4b. Adresa e mbajtësit të certifikatës/address of certificate holder.....		
5. Emri dhe informacioni i kontaktit të pronarit, nëse është i ndryshëm nga mbajtësi i certifikatës/Name and contact information of owner, if different from certificate holder:		
6. Vërtetohet se avioni i përshkruar më sipër është futur në Regjistrin e Avionëve Civilë Shqiptarë, në përputhje me Konventën e Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, të datës 7 dhjetor 1944 dhe me (†)...../ It is hereby certified that the above described aircraft has been duly entered on the Albanian Civil Aircrafts Register, in accordance with the Convention on International Civil Aviation dated 7 December 1944 and with the (†).....		
(Firma/Signature)..... Data e lëshimit/Date of issue..... (†) Vendosi referencën e rregullores së zbatueshme/Insert reference to applicable regulations		



SHTOJCA 2

CERTIFIKATA E ÇREGJISTRIMIT

*	REPUBLIKA E SHQIPËRISË/REPUBLIC OF ALBANIA Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/Ministry of Infrastructure and Energy AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL/CIVIL AVIATION AUTHORITY CERTIFIKATË ÇREGJISTRIMI/ CERTIFICATE OF DEREGISTRATION	*
1. Shenja e shtetësisë ose e përgjithshme dhe shenja e regjistrimit/ Nationality or common mark and registration mark	2. Prodhuesi dhe përcaktimi i prodhuesit të avionit/Manufacturer and manufacturer's designation of aircraft	3. Numri serial i avionit/ Aircraft serial no.
4a. Lëshuar për/Issued to (emri i mbajtësit të certifikatës/name of certificate holder)		
Baza e regjistrimit/Basis of registration (shëno njërën): _ pronësi mbi avionin/ownership of aircraft _ operator i avionit/operator of aircraft _ tjetër/other (shpjego):.....		
4b. Adresa e mbajtësit të certifikatës/address of certificate holder..... 5. Emri dhe informacioni i kontaktit të pronarit, nëse është i ndryshëm nga mbajtësi i certifikatës/Name and contact information of owner, if different from certificate holder:		
6. Vërtetohet se avioni i përshkruar më sipër është hequr nga Regjistri i Avionëve Civilë Shqiptarë, në përputhje me Konventën e Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, të datës 7 dhjetor 1944 dhe me/ It is hereby certified that the above described aircraft has been duly deregistered from the Albanian Civil Aircrafts Register, in accordance with the Convention on International Civil Aviation dated 7 December 1944 and with the (†).....		
(Firma/Signature).....		
Data e lëshimit/Date of issue..... (†) Vendos referencën e rregullores së zbatueshme/Insert reference to applicable regulations		

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë